



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 8678 Prot.

Tiranë, më 28.10. 2015

UDHËZIM

Nr. 46, datë 28.10.2015

PËR

**PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E DYTË TË
STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË "MASTER PROFESIONAL" DHE "MASTER I
SHKENCAVE"/"MASTER I ARTEVE TË BUKURA" NË INSTITUCIONET
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2015 - 2016**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, neneve 34, 36 dhe 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 135 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Vendimin nr. 638, datë 22.07.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e studimit, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2015 - 2016" i ndryshuar, Vendimin nr. 78, datë 08.02.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar dhe Vendimin nr. 1013, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave "Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)",

UDHËZOJ:

1. Pranimi i kandidatëve, shtetas shqiptarë, brenda vendit, në zbatim të shtojcës 1/1 të Vendimit nr. 638, datë 22.07.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015 - 2016", të ndryshuar, në programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë publik (IAL), në vitin akademik 2015 -

2016, realizohet në bazë të përzgjedhjes së bërë nga IAL-të, konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe sipas kriterëve shtesë të përcaktuara në statutet dhe rregulloret e tyre dhe të bëra publike paraprakisht.

2. Njësitë kryesore të IAL-ve publike, organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë "Master profesional" dhe "Master i shkencave"/"Master i arteve të bukura". Procesi menaxhohet dhe monitorohet nga rektoratet.
3. Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë "Master profesional" dhe "Master i shkencave"/"Master i arteve të bukura" të bëhen pranë sekretarive mësimore të njërive kryesore, nga data 29.10.2015 deri në datë 05.11.2015.
4. Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e ciklit të dytë kandidatët që:
 - a. kanë përfunduar në Republikën e Shqipërisë me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse, në një program të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, i cili rezulton i akredituar në momentin e diplomimit të studentit.
 - b. janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS.
5. Kandidati paraqitet personalisht dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a. Diplomë, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Për diplomat e fituara jashtë vendit, vërtetimin e njohjes në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar nga MAS, të diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës.
 - b. Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njësuar me origjinalin, e konfirmuar nga njësi përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar, paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (origjinal ose në rast fotokopjeje të saj, të njësuar me origjinalin, të konfirmuar nga njësi përkatëse arsimore vendore DAR/ZA).

Në rast se kandidatët kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të Vendimit të KM nr. 876, datë 3.11.2010 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike, të ndryshuar", dhe kanë dhënë me sukses

(me rezultate kaluese) provimet me zgjedhje të Maturës Shtetërore, paraqesin edhe dokumentin përkatës të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Provimeve.

Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA), ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave.

Kandidatët që kanë kryer shkollën e mesme jashtë vendit duhet të dorëzojnë dokumentin e njohjes të lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, të shoqëruar me fotokopje të njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë, të përkthyer në gjuhën shqipe, nëse është lëshuar në gjuhë të huaj, të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave, ose diplomës/dëftesës së shkollës së mesme të fituar në vendin përkatës, së bashku me certifikatën e notave, të legalizuar nga autoritetet drejtuese, vendorë apo qendrorë, të vendit ku ka përfunduar studimet, të njohura në Republikën e Shqipërisë ose të një dokumenti të lëshuar nga autoritetet arsimore kompetente mbi bazën e të cilit është kryer njohja nga MAS;

- c. Formulari i aplikimit sipas formatit të Shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij Udhëzimi;
 - d. Mandat pagesa e tarifës së aplikimit prej 2.500 lekë, paguar në Postën Shqiptare (për të gjithë kandidatët);
 - e. Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);
 - f. Dy fotografi personale.
6. Pranë njësive kryesore përgjegjëse të IAL-ve të ngrihen komisione *ad hoc* sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve dhe përzgjedhjen në bazë të meritës të atyre kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe kriteret shtesë të përcaktuara në statutet dhe rregulloret e tyre dhe të bëra publike paraprakisht.
 7. Brenda orës 16:00, të datës 09.11.2015, IAL-të publike të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, si dhe në faqet web të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara.
 8. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet nga data 10.11.2015 deri në datën 16.11.2015, pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore të IAL-së.
 9. Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi të zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat 10 - 12 Nëntor 2015, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në këtë

Udhëzim. MAS monitoron konkurset e pranimit dhe procedurat e ndjekura për vlerësimin e studentëve. IAL-të dërgojnë në MAS vlerësimin e kandidatit brenda datës 12 Nëntor 2015 në formë shkresore dhe elektronike në adresën linda.pustina@arsimi.gov.al dhe dhimiter.bako@arsimi.gov.al. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues nga data 13.11.2015 deri në datën 16.11.2015, duke paraqitur dhe mandat pagesën e tarifës së konkurrimit prej 3,000 lekë, paguar Postës Shqiptare.

10. IAL-ja shpall në vende të dukshme, publikon në faqen e saj web, si dhe ia përcjell MAS elektronikisht në adresën: linda.pustina@arsimi.gov.al dhe dhimiter.bako@arsimi.gov.al, listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datës 17.11.2015.
11. IAL-të publike i dërgojnë AKP-së brenda datës 19.12.2015, në rrugë postare, listën e studentëve të regjistruar për çdo program studimi të ciklit të dytë "Master Profesional" dhe "Master i shkencave"/"Master i Arteve të Bukura", në formë shkresore dhe elektronike në format EXCEL, me qëllim pajisjen me numër matricullimi në zbatim të Udhëzimit nr. 45, datë 19.12 2011, i ndryshuar.
12. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL publike dhe/ose private. AKP pas verifikimit i kërkon IAL-ve t'a çregjistrojë atë.
13. IAL-të shpallin publikisht hapjen e procedurave të aplikimit, datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshëm për aplikim dhe regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe IAL-së, si dhe në median e shkruar dhe elektronike.
14. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR



Formular aplikimi

Unë i/e nënshkruari/a _____, lindur më _____

emri atësia mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

1. Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit të ciklit të dytë:

 Master profesional Master i shkencave/Master i arteve të bukura

në _____, ID _____, në IAL _____

2. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

Autorizoj, gjithashtu Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër, me aplikimin, si dhe me të dhënat e deklaruara në këtë formular.

3. Deklaroj se nuk kam aplikuar për t'u regjistruar në asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015-2016.

4. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

5. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumentave të fallsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave

të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër Atësi Mbiemër

i kandidatit

Emër Mbiemër

i punonjësit që pranoi aplikimin

Firma

Firma